

Mësimi 3 Zbatimi i modelit ciklik politik

Detyrë Kërkimore

| | |
|--|---|
| <p>Kjo matricë përmbledh informacionin që i nevojitet një mësuesi për planifikimin dhe zhvillimin e mësimi.</p> <p>Trajnimi i kompetencave i referohet drejtpërdrejt EQD/EDNJ.</p> <p>Objektivi i mësimi tregon atë që nxënësit njohin dhe kuptojnë.</p> <p>Detyra e nxënësit, së bashku me metodën, formojnë bërthamën e procesit mësimor.</p> <p>Materialet në listën e plotë e mbështetin përgatitjen e mësimi.</p> <p>Koha në dispozicion jep një udhëzues të përafërt për menaxhimin e kohës së mësuesit.</p> | |
| Trajnimi i kompetencës | <p>Metodat : puna me projekt.</p> <p>Analiza dhe gjykimi politik : përshkrimi dhe gjykimi i një procesi të vendimmarrjes politike.</p> <p>Pjesëmarrja dhe veprimi: përgjegjësia, ushtrimi i lirive.</p> |
| Objektivat e të mësuarit | Nxënësit kuptojnë modelin ciklik të politikave dhe mund ta zbatojnë atë në çdo pjesë të informacionit për vendimmarrjen. |
| Detyrat e nxënësve | Nxënësit zbatojnë modelin ciklik të politikave për një çështje konkrete. |
| Materialet dhe burimet | Fletët e punës së nxënësit 6.1 dhe 6.2. Gazeta. |
| Metoda | Punë me projekt. |
| Koha në dispozicion | 1. Puna në grup. 35 min |
| | 2. Shpjegimi. 5 min |

Ky mësim i është përkushtuar punës në grupe. Nxënësit punojnë në mënyrë të pavarur, dhe janë përgjegjës për punën e tyre. Prandaj nga ata pritet që të mbledhin të gjithë informacionin që kanë nevojë.

Mësuesi mund të zgjedhë që t'i mbështesë grupet, duke u dhënë disa burime informacionesh, p.sh. statistika, tekste shkollorë, kopje të kushtetutës apo hyrje në internet. Mësuesi shikon nxënësit në punë; pikat e forta dhe dobësitë duke punuar pa udhëheqjen e mësuesit - siç do t'u duhet të bëjnë pas largimit nga shkolla - tregojnë nevojat e tyre në trajnimin e aftësive.

Mësuesi kërkon nga nxënësit që të marrin pjesë në një raund të shkurtër takimi në seancë plenare. Mësuesi dhe nxënësit planifikojnë prezantimet për mësimin e ardhshëm; në qoftë se një grup nuk ka përfunduar, kjo është përgjegjësi e nxënësve për të zgjidhur problemin.

Së pari, grupi duhet të shpjegojë se pse mendojnë se nuk e kanë "mbaruar". A ka informacion shtesë që nuk e kanë lexuar ende? Apo ata janë të pakënaqur me sasinë e pamjaftueshme të informacionit që kihin në dispozicion?

Mundësia më e preferueshme është që ta lësh problemin si përgjegjësi e grupit. Kjo duket e vështirë, por ajo i ngjan realitetit në jetën e rritur. Mundësitë e mësimi për nxënësit janë më të mëdha se gabimet në prezantimin e tyre. Një seksion pyetje-përgjigjesh pas katër mësimesh është i nevojshëm dhe duhet të lejohet kohë e mjaftueshme për këtë. Një zgjidhje alternative do të ishte që t'u jepet nxënësve një mësim shtesë. Kjo alternativë është më e përshtatshme në qoftë se shumica e nxënësve nuk e kanë përfunduar punën e tyre.